

KERKESE

KERKUES:



OBJEKTI: Kerkese per informacion dhe vendosje ne dispozicion te dokumentacionit

BAZA LIGJORE: Ligji nr.119 dt. 18.09.2014 "Per te Drejten e Informimit"
Neni 23 i Kushtetutes se Republikes se Shqiperise
Neni 10 i Konventes Europiane per te Drejten e Njeriut
Neni 19 i Paktit Nderkombetar mbi te Drejten Civile dhe Politike

U nderuar Z. Koordinator ,

Ne kuader te misionit dhe objektiva te Qendres per mbrojtjen e te drejtave te njeriut, ne baze te Ligjit nr.119, date 18.09.2014, *"Per te Drejten e Informimit"* kerkoj te infonnohem dhe te me vihet ne dispozicion dokumentacioni sa me poshte vijon:

- Sa eshte numri i punemarresve te cilet kane perfunduar marredhenien e punes per shkak te zgjidhjes se kontrates se punes nga ana e institucionit tuaj per periudhen 2017-2022?
- Sa prej tyre i jane drejtuar gjykates per zgjidhjen e mosmarreshjeve te lindura per shkak te zgjidhjes se kontrates se punes?
- Cfare vendimi ka marre gjykata per rastet konkrete? Ju lutem na vendosni ne dispozicion kopje te vendimeve gjyqesore?
- A ka patur raste ku punemarresve i'u eshte ofruar zgjidhja e konfliktit nepermjet ndermjetesimit? Nese po, sa raste jane zgjidhur nepermjet kesaj procedure?
- Sa eshte vlere e demshperblimit qe eshte akorduar punemarresit/gjyqfitues nga ekzekutimi i vendimeve gjyqesore?

Kjo kerkese bazohet ne nenin 3 paragrafi 1, te ligjit te siperpermendur, i cili shprehet:

"Cdo person gezon te drejten e njohjes me informacion publik, pa u detyruar te shpjegoje motivet"

Duke mbetur ne pritje te nje pergjigjeje te shpejte dhe pozitive nga ana Juaj,

Ju falenderoj per mirekuptimin,

